



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KESHILLI

Nr. 2493/prot

Koplik më: 01/09 / 2022

**V E N D I M**

*Nr 38 datë 31 / 08 / 2022*

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 31.08.2022, mbështetur në aktin normativ nr 3 datë 15.03.2020 neni 5, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.7/a, të Ligjit 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë" seksioni 3 neni 14, neni 15 pika 1/a, pika 2/b, neni 16/1.

VKM Nr.861 datë 10.12.2014 Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënie të medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë.

**VENDOSI**

1. T'i akordojë titullin "Qytetar Nderi "Z. Maliq Dan Xhakaj (pas vdekjes) me motivacionin:

"Për kontributin e pamohueshëm në Çlirimin e Atdheut dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë. Për punën e kurdohershme profesionale e humaniste në sistemin shëndetësorë në shërbim të njerëzve në nevojë, duke u bërë kështu burim frymëzimi e shëmbulli pozitiv për gjitha bluzat e bardha, duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe".

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Brendshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETAR**

Ilir Halaj

**SEKRETAR**

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 31.08.2022

Vota Pro 21

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 01.09.2022





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA MALESI E MADHE

Nr. 1493 prot

Koplik më: 30/08/2022

Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe  
Propozim për dhënie titulli " Qytetarë Nderi " i Bashkisë Malësi e  
Madhe z. Maliq Dan Xhakaj (pas vdekjes)



Maliq Dani (Xhakaj) u lind me 17 Maj 1922, në fshatin Reç , Nj,A,Shkrel, Bashkia Malësi e Madhe. Arsimin fillorë e më pas e mbaroi në fshatin e lindjes. I rritur në një familje fisnike e atdhetare dhe duke ndierë peshën e rënduar të vendit të vet nën pushtimin nazi-fashist ai edhe pse në moshë të re merr pjesë drejtpërdrejtë me armë në dorë në LANÇL duke u inkuadruar në Brigadën e 27 Sulmuese çka vërtetohet jo vetëm nga bashkëkohësit por edhe i dokumentuar me fakte nëpërmjet Dëshmive të paraqitura më lartë. Pas Çlirimit të Atdheut ndikoj me gjithë forcën rinore në rindërtimin e vendit por ajo që është më e rëndësishmja nuk la pas dore shkollimin apo kualifikimin e tij në sistemin shëndetësorë. Për një kualifikim të mëtejshëm profesional në vitet 1967-1970 mbaron Kursin e Plotë të Infermierisë në Shkodër. Edhe pas mbarimit të këtij kursi profesional si ndihmësmjek punoi në shumë zona të veriut e në mënyrë të veçantë në trevën Malësi e Madhe e më konkretisht në vendlindjen e tij në Zonën e Reçit ku me





profesionalizëm të lartë e humanizmin e tij prej një njeriu shëmbullorë mori edhe "titullin popullorë" Doktor Maliqi. Për punën e përkushtimit e tij ndër vite është vlerësuar me urdhëra e medalja të ndryshme çka i meritonte plotësisht. Edhe pse i dalë në pension asnjëherë nuk u shkëput nga profesioni e çanta e tij prej lëkure me ilaçe për tu shërbyer në çdo kohë e situatë të sëmurëve derisa mbylli sytë në vitin 2013 i rrethuar nga respekti e mirënjohja jo vetëm i familjarëve e të afërmëve por edhe nga i gjithë komuniteti reçjanë e më gjërë që me aq dashuri e ndërgjegje të pastër u shërbeu.

Për gjitha sa thamë më lartë i propozohet Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe ti jepet titulli " Qytetarë Nderi " (pas vdekjes) i Bashkisë Malësi e Madhe me

#### motivacion:

*"Për kontributin e pamohueshëm në Çlirimin e Atdheut dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë. Për punën e kurdohershme profesionale e humaniste në sistemin shëndetësorë në shërbim të njerëzve në nevojë, duke u bërë kështu burim frymëzimi e shëmbulli pozitiv për gjitha bluzat e bardha, duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe".*

